

VENDIM
Nr. 337, datë 22.5.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 3, DATË 9.1.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2019, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 3, datë 9.1.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2019, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 50 249 000 (pesëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e nëntë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

b) Pasqyra nr. 1 e vendimit zëvendësohet me pasqyrën nr. 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Pasqyra nr. 1/1

PLANI I RISHIKUAR I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2019

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2019 (lekë)
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	32,447,000
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	4,840,000
3.	Shërbime e furniturë	11,882,000
4.	Investime	1,080,000
	TOTALI	50,249,000